

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM KANDIDATËT NGA REPUBLIKA E KOSOVËS, ME ORIGJINË SHQIPTARE NGA MAQEDONIA E VERIUT, MALI I ZI, PRESHEVA, MEDVEGJA DHE BUJANOVCI, KANDIDATET ME STATUSIN E PERSONIT ME AFTËSI TË KUFIZUAR, ME STATUSIN JETIM, SI DHE KANDIDATET E KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE

VITI AKADEMIK 2026-2027

PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE NGA REPUBLIKA E KOSOVËS, KANDIDATËVE ME ORIGJINË SHQIPTARE NGA MAQEDONIA E VERIUT, MALI I ZI, PRESHEVA, MEDVEGJA DHE BUJANOVCI, KANDIDATËVE ME STATUSIN E PERSONIT ME AFTËSI TË KUFIZUAR, ME STATUSIN E JETIMIT, SI DHE TË KANDIDATËVE TË KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN, NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, ME KOHË TË PLOTË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË

Kandidatët nga **Republika e Kosovës, me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci**, kandidatët me statusin e personit me **aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe kandidatët e komunitetit rom dhe egjiptian**, përpara aplikimit, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit për çdo program studimi, sipas përcaktimit të IAL-së, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë në llogari të IAL-së pranë të cilit aplikon.

Aplikimi për programet e studimit në IAL dërgohet me postë pranë sekretarive mësimore ose depozitohet në zyrën e protokollit të njësive kryesore të IAL-ve.

Kandidatët nga Republika e Kosovës, me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe kandidatët e komunitetit rom dhe egjiptian, në momentin e aplikimit duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kandidatët nga Republika e Kosovës, me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, dorëzojnë:

- 1-formularin e aplikimit sipas formatit të shtojcës nr. 2, të këtij udhëzimi;
- 2- kopje të dokumentit të lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore që vërteton se diploma e arsimit të mesëm është njohur, të shoqëruar me fotokopje të diplomës/dëftesës dhe listës së notave;
- 3- dokument identifikimi (kartë identiteti, pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja e dokumentit të identifikimit;
- 4- dy fotografi;
- 5- kopje të mandatpagesës.

Shtojca nr. 2

Data: ____/____/2026

Formular aplikimi

Unë i nënshkruari _____, lindur më _____
emri atësia mbiemri
me kartë identiteti/pasaportë nr. _____

e-mail: _____, Tel: _____

Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit të ciklit të parë / profesional / integruar i ciklit të dytë _____ në IAL _____.

1. Deklaroj se aplikoj me kuotat për kandidatët

a) me kombësi shqiptare nga trojet (të shënohet me “x” vendi nga vjen kandidati):

- ☐ Republika e Kosovës;
- ☐ Mal i Zi;
- ☐ Maqedonia e Veriut;
- ☐ Preshevë;
- ☐ Bujanovci;
- ☐ Medvegja;

b) e huaj

Me shtetësi _____

Gjuhë amtare _____

Me arsim të mesëm _____

Adresë aktuale _____

2. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë të sipërcituara dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.

3. Deklaroj se do të regjistrohem vetëm në njërin nga programet e studimit në të cilin do të shpalllem fitues për vitin akademik në vijim.

4. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

5. Deklaroj se jam njohur me Udhëzimin përkatës dhe jam i qartë për procedurat e aplikimit, përzgjedhjes dhe regjistrimit.

6. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitur. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Emër Atësi Mbiemër kandidatit

Firma

Shtojca nr. 1
Deklaratë

Unë i nënshkruari _____, lindur më _____
emri atësia mbiemri
me kartë identiteti/pasaportë nr. _____

1. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë _____ Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin eventuale të tyre.

Autorizoj, gjithashtu institucionin e arsimit të lartë ku kam aplikuar, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.

2. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

3. Deklaroj se jam njohur me këtë udhëzim si dhe plotësoj kriteret e parashikuara në të për të aplikuar për transferim studimesh/program të dytë studimi.

4. Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e pranimit në programin e studimit, si dhe me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi, dhe jam dakord për sa më sipër.

5. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe/ose Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventalisht edhe organeve kompetente.

Emër Atësi Mbiemër i i kandidatit
mësimore

Firma

Vendi: _____ Data: ____ . ____ . 2026

Emër Atësi i punonjësit të sekretarisë

Firma

* Kandidatët **me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe kandidatët e komunitetit rom dhe egjiptian**, dorëzojnë:

1-. formularin e aplikimit sipas formatit të shtojcës nr.2, të këtij udhëzimi.

2-. kopje të diplomës/dëftesës, të shoqëruar me listën e notave.

3-. në momentin e regjistrimit kandidati fitues duhet të dorëzojë pranë IAL-së, deklaratën sipas shtojcës nr.5, të këtij udhëzimi si dhe kopje të njësuar me origjinalin, të diplomës së Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave, ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit. Kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011, të dorëzojë kopje të njësuar me origjinalin e dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme. Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme duhet të paraqesë, respektivisht, vërtetim notash të Maturës Shtetërore të lëshuar nga QSHA-ja dhe dublikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme dhe të vërtetuar në DRAP/ZVAP-në përkatëse, ose listën e notave të shkollës së mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit;

4- fotokopje të dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);

5- dy fotografi personale;

6- kopje të mandatpagesës;

Kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuar, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 8, të këtij kreu duhet të dorëzojnë edhe **kopje të librezës së të verbrit** të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të njësuar me origjinalin të vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (në vijim “KMCAP”);

d)Kandidatët me **statusin e jetimit**, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 8, të këtij kreu duhet të dorëzojnë edhe **kopje të dokumentit që certifikon statusin e jetimit** të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror;

e) kandidatët **romë dhe egjiptianë**, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 8, të këtij kreu duhet të dorëzojnë edhe **vetëdeklarim** ose një **dokument që vërteton që është rom apo ballkano-egjiptian**. Për përzgjedhjen e kandidatëve romë dhe egjiptianë, IAL-të marrin edhe ekspertizën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;

f) në rastet e aplikimeve nga kandidatët nga kategori të tjera të personave **me aftësi të kufizuar**, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 8, të këtij kreu duhet të dorëzojnë dhe **kopje të vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP)**.

Shtojca nr. 2

Data: ____/____/____2026

Formular aplikimi

Unë i nënshkruari _____, lindur më _____
emri atësia mbiemri
me kartë identiteti/pasaportë nr. _____, e-mail _____
celular _____.

Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit _____ në IAL _____.

1. Deklaroj se jam (të shënohet me “x” kategoria):

☐ të tjerë (PAK)

☐ jetim;

☐ Rom;

☐ Egjiptian.

2. Autorizoj institucionet e arsimit të lartë të sipërcituara dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.

3. Deklaroj se do të regjistrohem vetëm në njërin nga programet e studimit në të cilin do të shpallëm fitues për vitin akademik në vijim.

4. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

5. Deklaroj se jam njohur me Udhëzimin përkatës dhe jam i qartë për procedurat e aplikimit, përzgjedhjes dhe regjistrimit.

6. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitur. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Emër Atësi Mbiemër kandidatit

Firma

Shtojca nr. 1

Deklaratë

Unë i nënshkruari _____, lindur më _____,
me kartë identiteti, pasaportë nr. _____,

1. Autorizoj Institucionin e Arsimit të Lartë _____, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore, për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin eventual të tyre. Autorizoj, gjithashtu Institucionin e Arsimit të Lartë ku ka kam aplikuar, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore, për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.

2. Deklaroj se do të regjistrohem vetëm në një nga programet e studimit në të cilin do të shpallem fitues, për vitin akademik në vijim.

3. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

4. Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e pranimit në programin e studimit, si dhe pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi dhe jam dakord për sa më sipër.

5. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe dhe/ose Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Emër, Atësi, Mbiemër i kandidatit
mësimore

Emër, Atësi, Mbiemër i punonjësit të sekretarisë

Firma:

Firma:

Vendi: _____

Data: ____ . ____ . _____ 2026

AFATET E APLIKIMIT DHE REGJISTRIMIT PËR KANDIDATËT NGA REPUBLIKA E KOSOVËS, ME ORIGINË SHQIPTARE NGA MAQEDONIA E VERIUT, MALI I ZI, PRESHEVA, MEDVEGJA DHE BUJANOVCI, KANDIDATËT ME STATUSIN E PERSONIT ME AFTËSI TË KUFIZUAR, ME STATUSIN JETIM, SI DHE KANDIDATET E KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE 2026-2027

Referenca në Udhëzim	Afatet e përfundimit dhe data e realizimit
Aplikimi	02.09.2026 — 13.09.2026
Publikimi i listave jo përfundimtare të fituesve	18.09.2026
Shpallja e listave përfundimtare të kandidatëve fitues	26.09.2026
Regjistrimi i kandidatëve	26.09.2026-03.10.2026
Plotësimi i kuotave të mbetura bosh (ulja e vijës)	04.10.2026
Përfundimi i regjistrimeve i të gjithë kandidatëve fitues sipas dokumentave të dorëzuara në momentin e aplikimit.	10.10.2026